

VENDIM
Nr. 613, datë 12.9.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI BANKËS SË SHQIPËRISË TË SIPËRFAQES
982.68 M² TROTUAR, ME NUMRA PASURIE 6/151 DHE 6/153, QË NDODHET NË ZONËN
KADASTRALE 8380, TIRANË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 762, DATË
13.11.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI BANKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8, dhe të neneve 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Bankës së Shqipërisë të sipërfaqes 982.68 m² trotuar, me numra pasurie 6/151 dhe 6/153, që ndodhet në zonën kadastrale 8380, Tiranë, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, t’i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 762, datë 13.11.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bankës së Shqipërisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohet Ministri i Brendshëm, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha